



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Çelet panairi me produktet e 33 Startup-eve nga Shqipëria dhe Kosova

2017-05-14 17:55:00



Një panair i një lloji të veçantë është çelur mbrëmjen e së dielës në mjediset e Piramidës në Tiranë. Janë 33 nisma të reja biznesi, që ndryshe quhen edhe StartUp-e, nga Shqipëria dhe Kosova të cilat kanë ekspozuar produktet e tyre në këtë panair, i cili do të qëndrojë hapur në datat 14 – 16 maj.

Panairi mbarëkombëtar është organizuar në kuadër të Javës së Inovacionit 2017 nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Innovation Hub Tirana. Në ceremoninë e çeljes së Panairit janë prezantuar disa prej startup-eve më të suksesshme, të cilat tashmë kanë hedhur hapat e parë drejt shndërrimit të biznese të suksesshme dhe fitimprurëse.

“Ne jemi shumë të kënaqur që ju përfaqësoni pjesën më dinamike dhe më aktive të shoqërisë. Aftësoheni vetë, përparoni vetë dhe nëse ne mund t’ju japim një shtysë të vogël për t’ju ndihmuar siç është ky rast promovimi, apo siç është rasti i startup-it që do të përfaqësojë gjithë trevat tona në Singapor, në kompeticionin botëror, na vjen shumë mire”, ju është drejtuar ministrja Milena Harito pjesëmarrësve në panair, duke marrë fjalën në ceremoninë e zhvilluar.

Ministrja e Inovacionit është ndalur më pas në nevojën e zgjerimit të tregut të përbashkët, Shqipëri-Kosovë, çka do të rriste shancet për zhvillim në fushën e startup-eve, por edhe më gjerë. “Secili nga ju që operon në këtë sektor, e di mirë që jemi një treg i vogël dhe duhet patjetër ta zgjerojmë tregun tonë. Vetëm duke bashkëpunuar për një treg më të gjerë, për një treg Shqipëri- Kosovë, për një treg rajonal, për të gjithë ju do të krijohet më shumë mundësi zhvillimi”, ka thënë ministrja Harito.

Gjatë tre ditëve të panairit përfaqësuesit e startupeve do të prezantojnë idetë e tyre të biznesit në fusha të ndryshme si arsim, turizëm, shëndetësi, marketing dhe promocion, art dhe kreativitet, media e komunikim, arkitekturë e transport etj.